

VENDIM
Nr.947, datë 21.10.2010

PËR KRYERJEN E ANKETIMIT DHE TË REGJISTRIMIT TË PËRFITUESVE TË
NDIHMËS EKONOMIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 44 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kryerjen e anketimit dhe të regjistrimit të përfituesve të ndihmës ekonomike, me fondin prej 83 751 000 (tetëdhjetë e tre milionë e shtatëqind e pesëdhjetë e një mijë) lekësh, sipas preventivit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Instituti i Statistikës ngarkohet të kryejë anketimin dhe regjistrimin e përfituesve të ndihmës ekonomike, për llogari të Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, si dhe të kryejë të gjitha procedurat administrative për kryerjen e këtij procesi.

3. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta të kryejë të gjitha pagesat, në përputhje me fondet e miratuara dhe me dokumentacionin e paraqitur nga Instituti i Statistikave.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për vitin 2010 për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, në programin “Mbrojtja sociale”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Në 2010-Buxheti përfundimtar

Nr.	Zërat	Përshkrimi	Njësitë	Lekë/njësi	Lekë	Shuma gjithsej
1	Printimi i pyetësorëve dhe manualeve					
1.1	Pyetësorët dhe manualet e instruksioneve për anketues dhe supervizorë	98 000 pyetësorë (22 faqe)	2 156 000	8	17 280 000	17 280 000
2	Trajnimi i anketuesve dhe supervizorëve					
2.1	Akomodim i plotë	5 ditë x 557 persona x 5 500 lekë/ditë	2 785	5 500	15 314 000	15 314 000
2.2	Akomodim i pjesshëm	5 ditë x 109 persona x 1000	545	1 000	545 000	545 000
2.3	Pushim kafeje	(691 persona x 120 lekë)* 5	3 455	120	400 000	400 000
2.4	Sallë konference (5 ditë) për 6 trajnime	(5 ditë x 25000 lekë/ditë)*6	30	25 000	700 000	700 000
3	Mbledhja e të dhënave					
3.1	Pagesa e anketuesve	97 200 pyetësorë x 400 lekë/pyetësori	97 200	400	38 880 000	38 880 000
3.2	Dieta dhe transporti i anketuesve në zonat rurale	400 anketues x 1 muaj x 12 000 lekë/muaj)	400	12 000	4 800 000	4 800 000
3.3	Pagesa e supervizorëve	52 supervizorë x 1 muaj x 40 000 lekë/muaj	52	40 000	2 080 000	2 080 000
3.4	Dieta dhe transporti i supervizorëve	52 supervizorë x 1 muaj x 16 500 lekë/muaj	52	16 000	832 000	832 000
3.6	Pagesa për	12 koordinatorë x 1 muaj x 50 000	12	50 000	600 000	600 000

	koordinatorë kombëtarë	lekë/muaj				
4	Kontrolli dhe skanimi i pyetësorëve					
4.1	Operatorë kontrollorë për skanimin	60 persona x 1 muaj x 27 000 lekë/muaj	60	27 000	1 620 000	1 620 000
6	Mallra konsumi					
6.1	Mallra konsumi	Kancelari			700 000	700 000
					Gjithsej lekë	83 751 000

Shënim. Gjashtë trajnimet do të zhvillohen në rrethet: Tiranë, Kukës, Shkodër, Elbasan, Fier dhe Dibër.

Paga e një supervizori do të jetë e barabartë me kategorinë: specialist 4a, pa sigurim shoqëror.

000

Paga e një koordinatori do të jetë e barabartë me kategorinë: Përgjegjës sektori 3a, pa sigurim shoqëror.

Paga e një operatori do të jetë e barabartë me kategorinë VI, pa sigurim shoqëror.

83751 000

64671